



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:138390

Datë: 05.12.2023

Numri i dokumentit: 05015738

P.nr.718/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurit S. B. nga Peja rr. „A Q” nr.14 për shkak të veprës penale “*Sulmi*” nga neni 184 par. të KPRK-së dhe kundër të pandehurit V.K nga Peja rr. „A. Q” nr.14 për shkak të veprës penale „Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1366/20 të datës 19.10.2020, në bazë të nenit 229 par.5, nenit 357 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, jashtë seancës së shqyrtimit, me datë 05.12.2023, bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim me nr.ND.nr.2266/23 e lidhur me datë 20.11.2023 në mes të pandehurve-të dëmtuarve S.B nga Peja rr. „B e” me numër personal dhe V. K. nga P. rr. „A.Q” nr.. me numër personal

II. HEDHET – aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1366/20 të datës 19.10.2020.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit S.B nga Peja rr. „B.A” me nr. personal për shkak të veprës penale “*Sulmi*” nga neni 184 par. të KPRK-së dhe të pandehurit V.K nga Peja rr. „A.Q” nr.14 për shkak se ka kryer vepër penale „Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.1 të KPRK-së, për arsye se të pandehurit përkatësisht të dëmtuarit, kanë arritur marrëveshje për ndërmjetësim.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

V.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzë nën shenjën PP/II.nr.1366/20 të datës 19.10.2020, ndaj të pandehurit S.B Bilalli nga Peja rr. „A. Q” nr.14 për shkak të veprës penale „*Sulmi*” nga neni 184 par. të KPRK-së dhe të pandehurit V. K nga Peja rr. , A. Q.” nr.14 për shkak të veprës penale „*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale, kjo gjykatë me dt.20.11.2023, ka mbajtur shqyrtimin fillestar , në të cilën seancë, pas leximit të aktakuzës, gjykata sipas detyrës zyrtare konform dispozitave të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim dhe Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale ka informuar palët se lënda penale mund të referohet në procedurën e ndërmjetësimit me pëlqimin e të pandehurve-të dëmtuarve dhe të Prokurorit të Shtetit, me ç ‘rast palët njëzëri janë deklaruar se pajtohen që çështja penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, me qëllim të arritjes së marrëveshjes eventuale.

Pas pëlqimit të palëve për zgjidhjen e kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, gjyqtarja e çështjes e ka ndërprerë seancën dhe me datë 20.11.2023, ka marr vendimin për ta dërguar lëndën pranë koordinatorit për ndërmjetësim të kësaj gjykate që të procedoj lëndën në procedurë të ndërmjetësimit.

Me dt. 20.11.2023, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Pejë, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar nga ndërmjetësuasi Zymer Metaj, ndërmjet të pandehurit- dëmtuarit S.B me numër personal dhe të pandehurit- dëmtuarit V.K. me numër personal

Sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet të pandehurve- dëmtuarve ashtu që , palët ndërgjyqësve kanë deklaruar se marrëveshjen e lidhin në vullnet të plotë dhe pa shtytje nga askush. Njëkohësisht të njëjtit i kërkuar falje njëri tjetrit dhe në mënyrë reciproke shprehën keqardhje duke mos i kërkuar njëri tjetrit asnjë formë të kompensimit.

Palët pa ndonjë kërcënim dhe me vet dëshirë kanë shprehur gatishmëri që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit dhe nuk i kontestojnë asnjë nga pikat e lartpërmendura.

Qendra e Ndërmjetësimit me datë 20.11.2023, me numër të lëndës në ndërmjetësim Nd.2263/23 ka lidhur marrëveshjen e palëve të lartpërmendura për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit 229 paragrafi 5 të KPPRK-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve dhe është në pajtim me dispozitat e KPPRK-së dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, ku kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 229 par.5 , 357 par.1 nën par. 1.3, nenit 453 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 par.1 të Ligjit për ndërmjetësim, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti I Përgjithshëm
Divizioni Penal
P.718/20, me datë 05.12.2023

Bashkëpunëtorja profesionale

Gylaj Nepola

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi, pranë Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.